

Energji Ashta Sh.p.k
Pasqyrat Financiare
per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2011
(me raportin e audituesve te pavarur)

Permbajtja

Faqe

Raporti i Audituesve te Pavarur

Bilanci kontabel

1

Pasqyrave e te ardhurave dhe shpenzimeve

2

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital

3

Pasqyra e flukseve monetare

4

Shenime per pasqyrat financiare

5-14



KPMG Albania Sh.p.k
"Dëshmorët e Kombit" Blvd
Twin Towers Buildings
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

Telephone +355(4)2274 524
+355(4)2274 534
Telefax +355(4)2235 534
E-mail al-office@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

Raporti i Audituesve të Pavarur

Pronarit dhe drejtuesve të
Energji Ashta Sh.p.k.

Tiranë, 27 mars 2012

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të Energji Ashta Sh.p.k. ("Shoqëria"), të cilat përbëhen nga bilanci kontabël më 31 dhjetor 2011, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyra e ndryshimeve në kapitalin e vet dhe pasqyra e flukseve të parave për vitin e mbyllur në atë datë, dhe shënimet që përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, dhe për një kontroll të brendshëm, të tillë siç drejtimi vendos se është i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerësojmë këto rreziqe, ne marrim në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojmë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehim një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të sinqertë, në të gjitha aspektet materiale, të gjendjes financiare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2011, të rezultatit të saj financiar dhe të flukseve të saj monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2010 dhe për vitin e mbyllur në atë datë, ishin audituar nga një auditues tjetër, i cili më 20 qershor 2011 shprehu një opinion të pamodifikuar mbi ato pasqyra.

KPMG Albania Sh.p.k

KPMG Albania Sh.p.k.
"Dëshmorët e Kombit" Blvd.
Twin Towers Buildings,
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

Energji Ashta Sh.p.k.
Bilanci kontabel

(Shumat ne Lek)

	Shenime	31 dhjetor 2011	31 dhjetor 2010
Aktivet			
Aktivet afatshkurtra			
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	4	7,339,967,651	4,484,879,936
Aktive te tjera	5	2,172,989,647	1,081,182,667
Parapagime dhe shpenzime te shtyra		12,013,074	5,920,852
Totali i aktiveve afatshkurtra		9,524,970,372	5,571,983,455
Aktivet afatgjata			
Aktive afatgjata te trupezuara			
<i>Aktive ne proces</i>	6	22,386,867,341	13,015,743,244
<i>Aktive te tjera te trupezuara</i>	6	11,759,078	1,939,532
Totali i aktiveve afatgjata		22,398,626,419	13,017,682,776
Totali i aktiveve		31,923,596,791	18,589,666,231
Kapitali			
Kapitali aksionar	7	10,782,456,500	5,721,576,500
Humbje te mbartura		(337,886,090)	(252,132,840)
Totali i kapitalit		10,444,570,410	5,469,443,660
Detyrimet			
Detyrimet afatshkurtra			
Detyrime ndaj paleve te lidhura	8	4,524,119,389	4,584,389,111
Te pagueshme ndaj furnitoreve	9	2,393,536,903	1,654,777,460
Detyrime te tjera	10	19,402,582	2,833,265
Totali i detyrimeve afatshkurtra		6,937,058,874	6,241,999,836
Detyrimet afatgjata			
Hua afatgjata	11	14,509,638,134	6,713,390,264
Te pagueshme ndaj furnitoreve	9	32,329,373	164,832,471
Totali i detyrimeve afatgjata		14,541,967,507	6,878,222,735
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		31,923,596,791	18,589,666,231

Bilanci duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare te paraqitura ne faqet 5 deri 14.

Energji Ashta Sh.p.k.
Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve

(Shumat ne Lek)

	Shenime	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2011	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2010
Te ardhura		-	-
Kosto personeli	12	(31,240,662)	(17,831,144)
Zhvleresimi dhe amortizimi	6	(2,285,749)	(318,361)
Shpenzime te tjera operative	13	(90,560,637)	(102,187,084)
Rezultati nga veprimtaria operative		(124,087,048)	(120,336,589)
Interesi dhe te ardhura te tjera		129,205	592,867
Interesi dhe shpenzime te tjera financiare		(18,121)	(37,867)
Fitimi/(humbja) neto nga kurset e kembimit	14	38,222,714	(95,652,470)
Shpenzimet neto financiare		38,333,798	(95,097,470)
Humbja e vitit para tatimit		(85,753,250)	(215,434,059)
Tatimi mbi fitimin	15	-	-
Humbja neto e vitit		(85,753,250)	(215,434,059)

Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare te paraqitura ne faqet 5 deri 14.

Energji Ashta Sh.p.k.
Pasqyra e ndryshimeve ne kapital

(Shumat ne Lek)

	Kapitali aksionar	Humbje te akumuluar	Totali
Teprica me 1 janar 2010	125,000,000	(36,698,781)	88,301,219
Humbja neto e vitit	-	(215,434,059)	(215,434,059)
Kontribute nga aksioneret	5,596,576,500	-	5,596,576,500
Teprica me 31 dhjetor 2010	5,721,576,500	(252,132,840)	5,469,443,660
Humbja neto e vitit	-	(85,753,250)	(85,753,250)
Kontribute nga aksioneret	5,060,880,000	-	5,060,880,000
Teprica me 31 dhjetor 2011	10,782,456,500	(337,886,090)	10,444,570,410

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare te paraqitura ne faqet 5 deri 14.

Energji Ashta Sh.p.k.
Pasqyra e flukseve te parase

(Shumat ne Lek)


	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2011	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2010
Fluksi nga veprimtarite operative		
Humbja neto e periudhes	(85,753,250)	(215,434,059)
<i>Rregullime per:</i>		
Amortizimin	2,285,749	318,361
Humbja operative perpara ndryshimeve ne kapitalin qarkullues	(83,467,501)	(215,115,698)
Ndryshime ne parapagime dhe aktive te tjera	(1,096,720,614)	(1,064,293,134)
Ndryshime ne mjete monetare te kufizuara	(38,646,534)	(2,233,970,406)
Ndryshime ne te pagueshme ndaj paleve te lidhura	(60,269,722)	3,134,452,520
Ndryshime ne te pagueshme ndaj furnitoreve	606,256,345	(472,737,241)
Ndryshime ne detyrime te tjera	16,569,317	2,599,271
Mjete monetare neto (perdorur)/ nga veprimtarite operative	(656,278,709)	(849,064,688)
Tatim fitimi i paguar	(1,178,588)	(7,181,514)
Mjete monetare neto (perdorur)/ nga veprimtarite operative	(657,457,297)	(856,246,202)
Fluksi prej veprimtarive investuese		
Shtesa ne aktivet ne proces	(9,371,124,097)	(9,204,602,470)
Blerje e aktiveve te tjera te trupezuara	(12,105,295)	(2,257,893)
Mjetet monetare perdorur ne veprimtarite investuese	(9,383,229,392)	(9,206,860,363)
Fluksi nga veprimtarite financuese		
Rritje e kapitalit aksionar	5,060,880,000	5,596,576,500
Rritje e huave	7,796,247,870	6,713,390,264
Mjetet monetare neto nga veprimtarite financuese	12,857,127,870	12,309,966,764
Rritja neto e mjeteve monetare dhe ekuivalente me to	2,816,441,181	2,246,860,199
Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fillim te vitit	2,250,909,530	4,049,331
Mjete monetare dhe ekuivalente me to me 31 dhjetor	5,067,350,711	2,250,909,530

Pasqyra flukseve te parase duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare te paraqitura ne faqet 5 deri 14.


Keto pasqyra financiare jane aprovuar nga Drejtimi i Energji Ashta Sh.p.k. me 27 mars 2012 dhe nenshkruar nga:


Peter Stelzer

Administrator


Dietmar Reimer

Administrator


Fatbardha Bytyci

Drejtore Financiar

(Shumat ne Lek, nese nuk eshte shprehur ndryshe)

1. INFORMACION I PERGJITHSHEM

Energji Ashta Sh.p.k. ("Shoqeria") eshte regjistruar ne 11 dhjetor 2008. Zyra qendrore e shoqerise eshte e vendosur ne Tirane, Shqiperi.

Bazuar ne Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 1363, date 22 tetor 2008 " Per miratimin e Marreveshjes se Koncesionit, ndermjet Ministrise se Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes dhe Österreichische Elektrizitätswirtschafts-Aktiengesellschaft, per ndertimin, pronesine, perdorimin dhe transferimin e projektit per Hidrocentralin e ri ne Ashte, ne Republiken e Shqiperise", Qeveria Shqiptare, perfaqesuar nga Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes ("METE") dhe Shoqeria hyne ne nje Marreveshje Koncesioni, date 17 tetor 2008 ("Marreveshja e Koncesionit").

Objektivi kryesor i Shoqerise eshte zbatimi i Marreveshjes se Koncesionit. Koncesioni jepet per nje periudhe 35 vjecare, duke fillur nga 17 tetori 2008. Bazuar ne Marreveshjen e Koncesionit Shoqerise i caktohen si me poshte:

- (i) projektimi, financimi, ndertimi, testimi, zoterimi, veprimtaria dhe mirembajtja e hidrocentralit;
- (ii) pasurimi dhe rinovimi i objekteve ekzistuese, te zoteroje pjeset e pasuruara dhe rinovuara te objekteve ekzistuese sipas kerkesave ligjore dhe te perdore dhe mirembaje objektet ekzistuese;
- (iii) te gezoje uzufuktet;
- (iv) te kete te drejte perdorimi te ujit ne nivelin me te ulet te lumit Drin (brenda zones se koncesionit);
- (v) te furnizojte KESH me prodhim te perkohshem dhe me prodhim neto te energjise elektrike dhe te mbledhe pagesat e bleresve ne perputhje me kohen dhe kushtet e Marreveshjes per Shitjen e Energjise, dhe t'i shese paleve te treta prodhimin neto te energjise elektrike ne nje treg te hapur;
- (vi) t'i riktheje Qeverise Shqiptare perdorimin e zones se koncesionit dhe te drejten per transferim, dhe t'i transferoje Qeverise Shqiptare pronesine e hidrocentralit dhe objekteve ekzistuese me perfundimin e periudhes se koncesionit;
- (vii) te kete te drejten ekskluzive mbi cdo atribut mjedisor te lindur nga projekti, duke perfshire edhe certifikimet qe lidhen me te.

2. BAZA E PERGATITJES

(a) Deklarata e perputhshmerise

Pasqyrat financiare jane pergatitur ne perputhje me Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK).

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur mbi baza te kosos historike.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Keto pasqyra financiare jane paraqitur ne Lek Shqiptar ("Lek"), e cila eshte dhe monedha funksionale dhe e prezantimit per Shoqerine.

(d) Perdorimi i vleresimeve dhe gjykimeve

Pergatitja e pasqyrave financiare ne perputhje me SKK kerkon qe drejtimi te beje gjykime, vleresime dhe supozime, te cilat ndikojne ne zbatimin e politikave dhe ne shumat e raportuara te aktiveve, detyrimeve, te te ardhurave dhe shpenzimeve.

Vleresimet dhe supozimet e permendura rishikohen ne menyre te vazhdueshme. Rishikimet e vleresimeve kontabel njihen ne periudhen ne te cilen vleresimi rishikohet dhe ne periudhat e ardhshme nese ato ndikohen.

(Shumat ne Lek, nese nuk eshte shprehur ndryshe)

3. POLITIKAT KRYESORE KONTABEL

Politikat kontabel jane zbatuar ne menyre te qendrueshme pergjate gjithë periudhave te paraqitura ne keto pasqyra financiare.

(a) Aktivet afatgjata te trupezuara

(i) Njohja dhe matja

Aktivete afatgjata te trupezuara maten me kosto minus amortizimin e akumuluar (shih me poshte) dhe humbjet nga renia ne vlere, nesa ka.

Kosto perfshin shpenzimet qe lidhen drejtpersedrejti me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve te ndertuara vete, perfshin koston e materialeve dhe punes direkte (nese perfshihet), cdo kosto tjeter qe lidhet drejtpersedrejti me pergatitjen e aktiveve per gjendje pune, per qellimin e perdorimit te tyre; shpenzimet e cmontimit dhe heqjes se elementeve dhe rikthimin e terrenit ku ato ndodhen ne gjendjen fillestare, dhe koston e huamartjes qe lidhen me blerjen, ndertimin ose prodhimin e aktiveve perkatese.

Kur pjese te nje objekti te aktiveve afatgjata te trupezuara kane jetegjatesi te ndryshme, ato kontabilizohen si pjese te vecanta (perberes kryesore) te aktiveve afatgjata te trupezuara.

Fitimet dhe humbjet nga shitja e nje objekti te aktiveve afatgjata te trupezuara percaktohen duke krahasuar te ardhurat nga shitja me vleren e mbartur, dhe jane te njohura si te ardhura neto ne kategorine e te ardhurave te tjera, ne fitim ose humbje.

(ii) Kosto vijuese

Kostoja e zevendesimit te nje pjese te nje elementi te aktiveve afatgjata te trupezuara i shtohet vleres se mbetur te elementit nese eshte e mundur qe perfitime ekonomike ne te ardhmen qe lidhen me kete element do te rrjedhin ne Shoqeri, dhe kostoja e tij mund te matet me saktesi. Kostot e mirembajtjeve te vazhdueshme te aktiveve afatgjata te trupezuara njihen ne pasqyren e te ardhurave ne momentin kur ndodhin.

(iii) Zhvleresimi

Zhvleresimi i aktiveve te tjera te trupezuara perlllogaritet duke perdorur metoden e vleres se mbetur, me norma qe perafrojne nje jete ekonomike mesatare si me poshte:

Mjete transporti	20%
Mobilje	20%
Kompjuterat	25%
Pajisje	20%

Jeta e dobishme, metodat e zhvleresimit dhe vlera e mbetur, nese nuk jane jo-domethenese, rivleresohen ne daten e raportimit.

Aktivete ne proces nuk zhvleresohen.

(Shumat ne Lek, nese nuk eshte shprehur ndryshe)

3. POLITIKAT KRYESORE KONTABEL (vazhdim)

(b) Instrumentat financiare

Shoqeria mban vetem instrumenta financiare jo derivative, perfshire llogari te arketueshme tregtare dhe te tjera, mjete monetare dhe ekuivalente te saj, hua, llogari te pagueshme tregtare dhe te tjera.

Gjithe aktivet dhe detyrimet financiare njihen fillimisht ne daten e blerjes ne te cilen Shoqeria behet pale e parashikimeve kontraktuale te instrumentit. Nje aktiv ose detyrim financiar matet fillimisht me vleren e drejte shtuar kostot e transaksionit qe i atribohen drejtperdrejte blerjes ose emetimit te tij.

Shoqeria cregjistron nje aktiv financiar kur te drejtat kontraktuale ndaj flukseve monetare qe rrjedhin prej aktivitetit perfundojne, ose ajo i transferon te drejtat per te marre flukse monetare kontraktuale nga aktiviteti financiar nepermjet nje transaksioni, ku ne menyre thelbesore gjithë risqet dhe perfitimet e pronesisë së aktivitetit financiar transferohen. Cdo interes mbi aktivet financiare te transferuara qe krijohen ose mbahen nga Shoqeria, njihet si nje aktiv ose detyrim i vecante.

Shoqeria cregjistron nje detyrim financiar kur detyrimet e tij kontraktuale shlyhen, ose anulohen, ose perfundojne.

Pas njohjes fillestare, instrumentat financiare jo-derivative maten sic pershkruhet me poshte:

Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjete monetare dhe ekuivalente me to perfshijne parane ne arke, llogari rrjedhese ne banke, investime te tjera afatshkurtra me likuiditet te larte me maturitet origjinal tre muaj ose me pak, dhe perdoren nga Shoqeria ne manaxhimin e angazhimeve te saj afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalente me to mbarten me koston e amortizuar ne bilancin kontabel.

Huate

Huate maten me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Llogari te arketueshme tregtare dhe te tjera

Llogarite e arketueshme njihen fillimisht me vleren e drejte dhe me pas me kosto te amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvleresimi.

Llogarite te pagueshme tregtare dhe te tjera

Pas njohjes fillestare llogarite e pagueshme tregtare dhe te tjera njihen me koston e amortizuar.

(c) Kapitali aksionar

Kapitali aksionar i shoqerise njihet me vleren nominale.

(d) Provigjionet per risqe

Nje provigjion njihet kur Shoqeria, si pasoje e ngjarjeve te shkuara ka nje detyrim aktual, ligjor ose strukturor, qe mund te matet ne menyre te besueshme, dhe eshte e mundur qe te kerkohet nje dalje e flukseve te te mirave ekonomike per te shlyer detyrimin. Provigjionet llogariten duke skontuar flukset e ardhshme monetare me nje norme perpara tatimit qe reflekton vleresimet aktuale te tregut per vleren ne kohe te parase dhe risqet specifike te detyrimit.

(Shumat ne Lek, nese nuk eshte shprehur ndryshe)

3. POLITIKAT KRYESORE KONTABEL (vazhdim)

(e) Zhvleresimi

(i) Aktivet financiare

Nje aktiv financiar konsiderohet i zhvleresuar nese ka evidence objektive qe tregon se nje ose me teper ngjarje qe kane ndodhur kane patur nje ndikim negativ ne flukset e cmuara te ardhshme te mjeteve monetare te aktivitet financiar.

Humbja nga zhvleresimi i nje aktivi financiar te matur me koston e amortizuar eshte llogaritur si diference ndermjet vleres kontabel dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te vleresuara te mjeteve monetare skontuar me normen fillestare te interesit efektiv.

Aktivitet financiare individuale materiale, jane testuar per zhvleresim mbi baza individuale. Aktivitet e mbetura financiare jane vleresuar se bashku ne grupe qe kane karakteristika te ngjashme te riskut te kreditimit. Te gjitha humbjet nga zhvleresimi jane njohur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Nje humbje nga zhvleresimi rimerret ne rast se rimarrja mund te lidhet ne menyre objektive me ngjarje qe ndodhin pas njohjes se humbjes nga zhvleresimi. Rimarrja njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve

(ii) Aktivet jo-financiare

Vlerat e mbartura ne pasqyrat financiare te Shoqerise per aktivet jo-financiare, pervec inventareve, rishikohen ne cdo date raportimi, nese ka ndonje tregues per zhvleresimin. Ne rast se ekziston nje tregues i tille, atehere vleresohet vlere e rekuperueshme e aktivitet. Nje humbje nga zhvleresimi njihet ne rast se vlere e mbartur e nje aktivi tejkalon vleren e tij te rekuperueshme. Humbjet nga zhvleresimi njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Nje humbje nga zhvleresimi eshte njohur ne rast se vlere e mbartur e nje aktivi ose e njesise perkatese te gjenerimit te parase, tejkalon vleren e tij te rekuperueshme. Nje njesi gjenerimi e parase eshte grupi me i vogel, i identifikueshem i aktiveve, i cili gjeneron flukse parash te cilat jane te pavarura nga aktive dhe grupe te tjera. Humbjet nga zhvleresimi njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Vlere e rekuperueshme e nje aktivi ose njesise se gjenerimit te parase eshte vlere me e madhe midis vleres ne perdorim dhe vleres se drejte, minus koston e shitjes. Ne vleresimin e vleres ne perdorim, flukset e ardhshme te vleresuara te parase skontohen ne vleren aktuale, duke perdorur perqindjen e skontimit para takses, qe reflekton vleresimet aktuale te tregut, te vleres ne kohe te parase, dhe risqet specifike te aktivitet.

Ne lidhje me aktivitet e tjera, nje humbje nga zhvleresimi, rimerret ne rastin kur ka nje tregues qe humbja nga zhvleresimi nuk ekziston me, dhe ka ndodhur nje ndryshim ne vleresimet e perdorura per te percaktuar vleren e rekuperueshme. Nje humbje nga zhvleresimi rimerret ne masen qe vlere e mbetur e aktivitet, nuk tejkalon vleren kontabel qe do ishte percaktuar, neto nga amortizimi, ne rast se nuk do ishte njohur humbje nga zhvleresimi.

(f) Qiraja operative

Pagesat e kryera sipas qirase operative njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve mbi baza lineare gjate kohezgjatjes se qirase. Pagesat nxiteses te qirase te marra njihen si pjese integrale e shpenzimit total te qirase, pergjate kohezgjatjes se qirase.

(g) Perfitimet e punonjsve

Kontributet e detyrueshme te sigurimeve shoqerore dhe shendetsore

Shoqeria, ne rrjedhen normale te biznesit, kryen pagesa ne emer te saj dhe ne emer te punonjesve te saj ne vend, me qellim pagesen e kontributit te detyrueshem te sigurimeve shoqerore dhe shendetsore, sipas legjislacionit vendas. Koston ne emer te Shoqerise ne lidhje me pagesen e ketyre kontributeve njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve ne periudhen kur ndodhin.

(h) Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve ne periudhen ne te cilen ndodhin.

(Shumat ne Lek, nese nuk eshte shprehur ndryshe)

3. POLITIKAT KRYESORE KONTABEL (vazhdim)

(i) Te ardhurat dhe kostot financiare

Te ardhurat financiare perfshijne te ardhurat nga interesat nga fondet e investuara. Te ardhurat nga interesat njihen ndersa perllogariten ne pasqyren e te ardhurave, duke perdorur metoden e interesit efektiv. Fitimet dhe humbjet nga veprimet ne monedhe te huaj raportohen ne baza neto.

(j) Tatimi mbi te ardhurat

Tatimet mbi te ardhurat njihen ne perputhje me kerkesat e legjislacionit shqiptar te tatimit mbi te ardhurat. Shoqeria nuk njeh tatim te shtyre dhe shpenzimi i tatimit mbi te ardhurat perbehet vetem nga tatimi i periudhes aktuale.

(k) Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedhe te huaj jane perkthyer ne monedhen funksionale raportuese, me kursin e kembimit te dates se transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare ne monedhe te huaj ne daten e raportimit jane perkthyer ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne ate date. Humbja ose fitimi nga zerat monetare, eshte diferenca midis kosos se amortizuar ne monedhen funksionale ne fillim te periudhes, e rregulluar per interesin efektiv dhe pagesat gjate periudhes, dhe kosos se amortizuar ne monedhe te huaj, e perkthyer me kursin e kembimit ne fund te periudhes. Aktivet dhe detyrimet jo monetare ne monedhe te huaj te cilat jane matur me vleren e drejte, perkthehen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten e percaktimit te vleres se drejte.

4. MJETE MONETARE DHE EKVIVALENTE ME TO

	31 dhjetor 2011	31 dhjetor 2010
Llogari rrjedhese		
<i>Ne Lek</i>	13,401,497	2,370,632
<i>Ne Euro</i>	13,402,099	11,077,033
Depozita me afat	7,313,164,055	4,471,432,271
Totali	7,339,967,651	4,484,879,936
Mjete monetare te kufizuara	(2,272,616,940)	(2,233,970,406)
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	5,067,350,711	2,250,909,530

Mjetet monetare te kufizuara paraqesin shuma te bllokuara nga Raiffeisen Bank per periudha kontraktuale prej me shume se 3 muaj. Shumat jane te bllokuara per te siguruar garancite bankare te marra. Keto shuma jane ne Euro.

5. AKTIVE TE TJERA

Aktive te tjera perbehen si me poshte:

	31 dhjetor 2011	31 dhjetor 2010
TVSH e arketueshme	2,137,673,227	1,073,043,103
Parapagime per tatim fitimin	8,360,102	7,181,514
Parapagime te tjera tatimore	6,435,019	-
Prepayments to suppliers	20,521,299	958,050
Totali	2,172,989,647	1,081,182,667

Shoqeria ka bere nje kerkese per rimbursimin e TVSH-se. Gjithsesi, nuk eshte dhene ndonje miratim nga autoritetet, deri ne daten e aprovimit te ketyre pasqyrave financiare, per ndonje rimbursim te tille.

(Shumat ne Lek, nese nuk eshte shprehur ndryshe)

6. AKTIVE AFATGJATA TE TRUPEZUARA

	Aktive ne proces	Aktive te tjera te trupezuara	Totali
Kosto			
Me 1 janar 2010	3,811,140,774	-	3,811,140,774
Kosto ndertimi	9,039,563,050	-	9,039,563,050
Kosto huamarrjeje	165,039,420	-	165,039,420
Shtesa te tjera	-	2,257,893	2,257,893
Me 31 dhjetor 2010	13,015,743,244	2,257,893	13,018,001,137
Kosto ndertimi	8,757,230,783	-	8,757,230,783
Kosto huamarrjeje	613,893,314	-	613,893,314
Shtesa te tjera	-	12,105,295	12,105,295
Me 31 dhjetor 2011	22,386,867,341	14,363,188	9,383,229,392
Zhvleresimi i akumuluar			
Me 1 janar 2010	-	-	-
Shpenzimi i vitit	-	(318,361)	(318,361)
Me 31 dhjetor 2010	-	(318,361)	(318,361)
Shpenzimi i vitit	-	(2,285,749)	(2,285,749)
Me 31 dhjetor 2011	-	(2,604,110)	(2,604,110)
Vlera e mbartur			
Me 1 janar 2011	3,811,140,774	-	3,811,140,774
Me 31 dhjetor 2010	13,015,743,244	1,939,532	13,017,682,776
Me 31 dhjetor 2011	22,386,867,341	11,759,078	22,398,626,419

Kostot e ndertimit perfshijne blerjen e tokes, tarifat per licensat, pune inxhinierike dhe civile, pajisje eletrike dhe hidro-mekanike, konsulence, projektim dhe zbatimin e tij, vleresime te ndikimit mjedisor, monitorime ekologjike dhe investigime te terrenit.

(Shumat ne Lek, nese nuk eshte shprehur ndryshe)

7. KAPITALI AKSIONAR

Kapitali i paguar eshte i regjistruar ne Lek. Energji Ashta Sh.p.k. fillimisht ishte ne pronesi te Verbund-International GmbH. Disa transferime pasuese te kapitalit aksionar u bazuan ne marreveshjet e blerjes se aksioneve si me poshte:

- 20 prill 2010: 50% e kapitalit aksionar u transferua nga Verbund-International GmbH tek EVN A.G;
- 13 janar 2011: 50% e kapitalit aksionar u transferua nga Verbund-International GmbH tek Hydro Power Verbund AG;
- 6 shtator 2011: Hydro Power Verbund AG dhe EVN AG transferuan 100% te aksioneve tek Ashta Beteiligungsverwaltung GmbH.

Bazuar ne nje Rezolute te Aksionereve, me date 18 tetor 2011, kapitali u rrit me 5,060,880,000 Lek kontribut ne mjete monetare. Pas kesaj rritje, struktura e pronesise ishte si me poshte:

	<i>31 dhjetor 2011</i>	
	Total in Lek	%
Ashta Beteiligungsverwaltung GmbH	10,782,456,500	100

8. DETYRIMET NDAJ PALEVE TE LIDHURA

Detyrimet ndaj paleve te lidhura paraqet tepricen e nje llogarie me VERBUND Finanzierungsservice GmbH. Kjo llogari perdoret per te mbledhur ose shlyer pagesat me palet e treta ose palet e lidhura, dhe per te marre fonde nga pronaret. Keto teprica jane ne Euro dhe mbartin nje interes Euribor 1-mujor + 1.3%.

9. TE PAGUESHME NDAJ FURNITOREVE

	31 dhjetor 2011	31 dhjetor 2010
Pune ndertimi te pafaturuara	306,864,006	856,354,258
Detyrime te mbajtura	433,298,900	-
Detyrime te tjera ndaj furnitoreve	1,653,373,997	798,423,202
Detyrime afatshkurtra	2,393,536,903	1,654,777,460
Detyrime te mbajtura	32,329,373	164,832,471
Detyrime afatgjata	32,329,373	164,832,471
Totali	2,425,866,276	1,819,609,931

Punet e ndertimit te pafaturuara paraqesin punen e kryer perpara fundit te vitit, por te pafaturuara ende.

Detyrimet e mbajtura paraqesin nje perqindje te shumes se faturuar nga furnitoret, e cila bazuar ne marreveshje kontraktuale, eshte e pagueshme pasi puna te perfundohet.

Detyrime te tjera ndaj furnitoreve lidhen kryesisht me koston e aktiveve ne proces.

(Shumat ne Lek, nese nuk eshte shprehur ndryshe)

10. DETYRIME TE TJERA

Detyrime te tjera perbehen si me poshte:

	31 dhjetor 2011	31 dhjetor 2010
Shpenzime te perlllogaritura	17,750,398	644,920
Sherbime te pafaturuara	1,319,835	1,609,732
Detyrime ndaj punonjesve	93,214	-
Tatimit mbi te ardhurat e personelit	226,410	190,689
Sigurime shoqerore	-	187,711
Detyrime dhe taksa te tjera	12,725	77,012
Detyrime te tjera	-	123,201
Totali	<u>19,402,582</u>	<u>2,833,265</u>

11. HUATE AFATGJATA

Huate jane marre nga palet e meposhtme:

	31 dhjetor 2011	31 dhjetor 2010
Verbund International Finance GmbH	7,254,819,067	3,356,695,132
Bawag P.S.K Bank	7,254,819,067	3,356,695,132
Totali	<u>14,509,638,134</u>	<u>6,713,390,264</u>

Ne 15 tetor 2010 Shoqeria mori dy hua me nje total limiti kreditimi prej 140 milione Euro dhe kohezgjatje prej 10 vjet. Keto hua mbartin nje interes prej Euribor 3-mujor + 1.35%. Huate jane garantuar nga aksioneret, dhe per keto garanci Shoqeria u paguan atyre, nje tarife prej 2% mbi cdo disbursim.

12. KOSTOT E PERSONELIT

Kostot e personelit perbehen si me poshte:

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2011	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2010
Paga	29,704,021	16,835,876
Sigurime shoqerore	1,536,641	995,268
Totali	<u>31,240,662</u>	<u>17,831,144</u>

Ne 31 dhjetor 2011, Shoqeria kishte te punesuar 9 punonjes (2010: 8).

(Shumat ne Lek, nese nuk eshte shprehur ndryshe)

13. SHPENZIME TE TJERA OPERATIVE

Shpenzimet e tjera operative perbehen si me poshte:

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2011	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2010
Sherbime profesionale konsulence	20,796,737	17,511,303
Shpenzime per publicitet e marketing	9,871,287	6,177,210
Shpenzime qiraje	13,956,145	10,084,277
Shpenzime per sigurime	219,277	15,500
Komisione bankare	403,663	233,576
Materiale zyre	1,450,861	753,911
Shpenzime transporti	50,579	2,785
Shpenzime perfaqesimi	6,218,849	1,688,815
Taksa dhe tarifa te tjera	790,786	1,164,040
Shpenzime postare dhe telefoni	3,329,495	2,458,065
Mirembajtje dhe riparime	14,799,855	61,231,382
Gjoha	18,341,311	384,290
Energji elektrike, uje, etj.	331,792	481,930
Totali	90,560,637	102,187,084

14. FITIMI/(HUMBJA) NGA KURSI I KEMBIMIT

Te ardhurat dhe shpenzimet financiare perbehen si me poshte:

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2011	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2010
Humbja nga kursi i kembimit	(201,147,287)	(129,736,084)
Fitimi nga kursi i kembimit	239,370,001	34,083,614
Neto	38,222,714	(95,652,470)

(Shumat ne Lek, nese nuk eshte shprehur ndryshe)

15. SHPENZIMI I TATIM FITIMIT

Shoqeria percakton tatimin ne fund te vitit ne perputhje me Legjislacionin tatimor shqiptar. Ne vitet 2011 dhe 2010, norma e tatim fitimit ishte 10% mbi rezultatin tatimor. Me poshte paraqitet rakordimi i tatim fitimit te perlllogaritur me normat e aplikuesheme tatimore me shpenzimin:

	Norma tatimore efektive	2011	Norma tatimore efektive	2010
Humbja perpara tatimit		(85,753,250)		(215,434,059)
Tatimi prej 10%	10%	(8,575,325)	10%	(21,543,406)
Shpenzime te pazbritshme	(2%)	1,812,503	(1%)	1,962,904
Humbje jo te mbartura	(8%)	6,762,822	(9%)	19,580,502
Shpenzimi i tatim fitimit		-		-

Bazuar ne legjislacionin Shqiptar humbjet e akumuluar nuk mund te mbarren ne rastet kur ka pasur ndryshim ne strukturen aksionare te Shoqerise prej me shume se 25%.

16. TRANSAKSIONET ME PALET E LIDHURA

Ne koston e aktiveve ne proces eshte perfshire nje shume prej 286,559,490 Lek, paguar Verbund Hydro Power AG. Per me teper, Shoqeria ka marre financim nga palet e lidhura dhe garanci prej tyre per huate e marra (shih shenimet 8 dhe 11)

Shpenzimet e tjera operative te njohura ne 2011 ishin si me poshte:

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2011
Verbund Hydro Power AG	3,589,843
Verbund Finanzierungsservice	1,402,845
	<hr/>
	4,992,688

17. ANGAZHIME DHE KUSHTEZIME

Ligjore

Ne rrjedhen normale te biznesit, Shoqeria ndeshet me pretendimet ligjore dhe gjyqesore; menaxhimi i Shoqerise eshte i mendimit se asnje humbje materiale nuk do te shkaktohet ne lidhje me kerkesat ligjore te pazgjidhura me 31 dhjetor 2011.

Angazhimet e qirase operative

Shoqeria ka hyre ne angazhime te qirase per zyrat e saj. Shoqeria mund te anulloje keto qira duke lajmeruar 3 muaj perpara, prandaj me 31 dhjetor 2011, maksimumi i angazhimeve te paanullueshme, te pagueshme jo me vone se 1 vit eshte 1,604,642 Lek (2010: 1,302,578 Lek).

18. NGJARJET PAS DATES SE RAPORTIMIT

Nuk ka pasur ndonje ngjarje pasuese domethenese pas dates se raportimit qe do te kerkonte rregullim ose shpjegim ne keto pasqyra financiare.